

QYTETARËT PËR NDRYSHIM

PRILL-QERSHOR 2026 // CIVICAMOBILITAS.MK

BULETIN NR.25



Foto: Mirjana Gjorgjievska/MED



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



KUR ANGAZHIMI VAZHDON - REZULTATET VIJNË

Më shumë se tre vjet. Aq kohë iu desh një kërkesë për një të drejtë themelore - pushim i paguar i lehonisë për gratë fermere - që të kalonte rrugën nga një fushatë publike, përmes debatit parlamentar, deri te një vendim gjyqësor i formës së prerë që konstatoi diskriminimin dhe e detyroi shtetin të ndryshojë Ligjin për sigurimin shëndetësor. Dhe rruga ende nuk ka përfunduar.

Civika mobilitas “hyri” në këtë histori në vitin 2023, kur mbështeti Koalicionin “Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara” – MARCJINAT dhe partnerët e tij në aktivitetet e tyre të avokimit për pushim të paguar të lehonisë dhe pushim për shkak të sëmundjes ose lëndimit, të destinuara për mbi 14.000 gra të regjistruara si fermere individuale. Përmes ngjarjeve publike, analizës së politikave publike, fushatës dhe komunikimit me deputetët, organizata rriti ndjeshëm ndërgjegjësimin për problemin. U paraqit një propozim-ligj për ndryshimin e Ligjit për Sigurimin Shëndetësor, ndërsa të gjithë deputetët votuan për nevojën e miratimit të tij. Fushata dokumentare “Xixëllonjat e mundimit”, në të cilën vetë fermeret rrëfenin për përpjekjet e tyre të përditshme, e bëri problemin të dukshëm për publikun dhe për Komisionin Evropian, i cili e përfshiu atë në raportin e progresit të vendit.

Megjithatë, lëvizjet u ndalën pikërisht para ndryshimit konkret - ligji nuk u miratua. Suksesi ishte i pjesshëm: ndërgjegjësimi u rrit dhe vullneti politik u shpreh, por e drejta mbeti e panjohur.

Civika mobilitas vazhdoi t'i mbështesë organizatat në përpjekjet e tyre për zgjidhjen e këtij problemi. Përmes projektit të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe partnerëve të tij u bënë përpjekje të reja. Organizata

dhe Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMĐ) paraqitën padi me interes publik pranë Gjykatës Themelore Civile në Shkup kundër Qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Gjykata miratoi një vendim me të cilin konstatoi diskriminim indirekt, ndërsektorial dhe të vazhdueshëm ndaj fermereve individuale dhe i detyroi autoritetet të iniciojnë ndryshime në Ligjin për sigurimin shëndetësor.

Ky shembull edhe një herë e konfirmon nevojën për mbështetje afatgjatë të organizatave qytetare dhe thekson se mbështetja afatgjatë është më e rëndësishme se ndërhyrjet afatshkurtra, sidomos kur bëhet fjalë për avokim, ngritje të vetëdijes ose ndërtim kapacitetesh. Ndryshimet në politika dhe në qëndrimet e shoqërisë rrallë vijjnë përmes një projekti të vetëm - ato kërkojnë këmbëngulje, vazhdimësi dhe besim mes donatorit dhe organizatës, si dhe mes organizatës dhe grupeve të saj të synuara. Mbështetja e Qeverisë së Zvicrës përmes Civika mobilitas e mundëson këtë vazhdimësi, në këtë rast duke e përshkuar rrugën nga fushata dhe avokimi deri te procesi gjyqësor. Shembuj të tillë e bëjnë më të qartë për publikun rolin e organizatave qytetare dhe kontributin e tyre në ndryshimet shoqërore.

Në këtë numër të “Qytetarët për ndryshim”, shikoni edhe arritjet e tjera të organizatave qytetare, pa përjashtim të lidhura me nevojat e qytetarëve.

Lexim të këndshëm!

Gonce Jakovleska
Koordinator kombëtar i
Civika mobilitas për IKO

Falënderojmë: Departamentin për bashkëpunim me organizatat joqeveritare pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë, Qendrën Burimore Qytetare (QBQ), Shoqatën Lëvizja Evropiane në Republikën e Maqedonisë së Veriut (LEMV), Shoqatën e ekologëve “Natyra” – Strugë, Institutin për Demokraci “Societas Civilis” Shkup (IDSCS), Shoqatën Humanitare “Nëna” Kumanovë, Organizatën e Grave “Lobi i grave” – Demir Kapi, Institutin për Hulumtimin e Zhvillimit Shoqëror RESIS, Shoqatën Ekologjike të Maqedonisë (SHEM), Kryqin e Kuq të RMV-së – Organizata Komunale Ohër, Institutin për Hulumtim dhe Analizë të Politikave Romalitiko, Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (KHDNJ), HERA - Asociacioni për Edukim Shëndetësor dhe Hulumtim, Shoqatën ESE, Institutin Ballkanik për Bashkëpunim Rajonal (IBBR), Shoqatën e Gazetarëve (SHGM), Konekt, Rrjetin “Stella”, “Eko-vest” Shkup, Promo Idea – Strumicë, “Hartefakt”, Kombet e Bashkuara - Maqedonia e Veriut, Bashkësinë e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale – BNJVL, OJQ Info qendra (NVO-IC), Fondacionin Metamorfozis, për mbështetjen dhe qasjen në informacione gjatë përgatitjes së teksteve për këtë numër.

Foto arkivi: Civika mobilitas, Qendra Burimore Qytetare, SHGM, IDSCS, HERA, BCSDN, SHEM, KHDNJ, Romalitiko, Lëvizja Evropiane, Shoqata e ekologëve “Natyra” – Strugë, Kryqi i Kuq i RMV-së – Organizata Komunale Ohër, OJQ Info qendra, SHH “Nëna”, OG “Lobi i grave” Demir Kapi, Rrjeti “Stella”, Konekt, Promo Idea – Strumicë, “Eko-vest” Shkup, OKB Maqedonia e Veriut, Fondi Hartefakt, Departamenti për bashkëpunim me organizatat joqeveritare.



TEMA

ANGAZHIMI QYTETAR

Kontrolle falas me rastin e Ditës Botërore të Shëndetit



Me rastin e Ditës Botërore të Shëndetit, e cila sivjet u shënua me moton “Së bashku për shëndetin, qëndro pas shkencës”, HERA-Asociacioni për Edukim Shëndetësor dhe Hulumentim, në partneritet me Komunën Qendër, më 6 prill organizoi kontrolle parandaluese dhe konsultime shëndetësore falas për qytetarët.

Në këtë ngjarje, qytetarët mundën falas të matin tensionin e gjakut dhe nivelin e glukozës në gjak, si dhe të marrin këshilla dhe konsultime me gjinekolog, ortoped, dermatolog dhe infektolog. Nga HERA theksojnë se me iniciativa të tilla, së bashku me Komunën Qendër, kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e qasshmërisë së shërbimeve parandaluese dhe i nxisin qytetarët të kujdesen më aktivisht për shëndetin e tyre.

Nga organizata theksojnë se motoja e sivjetme nënvizon nevojën që politikat shëndetësore të bazohen në dëshmi, por edhe që këto dëshmi të shndërrohen në shërbime konkrete, të qasshme dhe të drejta për të gjithë qytetarët, gjë që nënkupton investime më të mëdha në parandalim, shpërndarje më të mirë gjeografike të shërbimeve shëndetësore dhe një sistem që adreson paparazitë.

Edhe pse parandalimi është segment kyç i sistemit shëndetësor, analizat e organizatave qytetare tregojnë se qasja në këto shërbime mbetet seriozisht e kufizuar.

Sipas gjetjeve të cituara nga HERA, madje 80% e grave kanë paguar për shërbime gjinekologjike që duhej të ishin falas, ndërsa vetëm rreth 15% e grave janë përfshirë në skring për kancerin e qafës së mitrës gjatë një periudhe trevjeçare, në vend të 75% të nevojshëm. Shqetësues është edhe fakti se 92% e grave rreth nuk janë të informuara se kanë të drejtë për kontroll gjinekologjik falas. Njëkohësisht, theksojnë nga organizata, qasja në testimin për HIV përmes organizatave qytetare rezulton dukshëm më efektive: një rast pozitiv në 150 testime, kundrejt një në 1.150 në institucionet shëndetësore.

Edhe pse ekzistojnë programe parandaluese, zbatimi i tyre në praktikë mbetet i kufizuar për shkak të financimit të pamjaftueshëm, qasshmërisë së dobët dhe informimit të pamjaftueshëm, gjë që i prek veçanërisht grupet e cenueshme dhe gratë nga zonat rurale, paralajmërojnë nga HERA. Ata shtojnë se parandalimi nuk duhet të jetë aktivitet i rastësishëm, por shërbim i vazhdueshëm dhe i qasshëm për të gjithë, sepse vetëm përmes kujdesit në kohë, informimit dhe qasjes së barabartë në shërbime shëndetësore mund të zvogëlohen rreziqet shëndetësore dhe të sigurohet cilësi më e mirë e jetës.

Përfundoi kampi i dytë edukativ në Dojran i Shoqatës Ekologjike të Maqedonisë

BNë periudhën nga 16 deri më 18 maj, Shoqata Ekologjike e Maqedonisë mbajti edicionin e dytë të kampit edukativ në Dojran, i cili është pjesë e projektit “Mbrotja dhe revitalizimi i ligatinave mesdhetare” – PROZHUM. Kampi mblodhi 33 nxënës të shkollave të mesme, disa prej të cilëve kishin marrë pjesë edhe në edicionin e parë, ndërsa pothuajse gjysma morën pjesë për herë të parë.

Për tre ditë, Liqeni i Dojranit ishte klasë në natyrë për pjesëmarrësit. Ata numëruan dhe identifikuan shpendë ujorë, hulumentuan amfibë dhe zvarranikë, studiuan diversitetin bimor dhe përmes analizave laboratorike dhe

mikroskopike përpunuan mostra algash, ndërsa njohuritë i thelluan edhe përmes lojërave edukative.

“Të rinjtë kanë interes të madh për mjedisin jetësor kur njohuritë u përcillen përmes përvojave që janë afër tyre. Në një kamp të tillë ata mësojnë të punojnë në ekip, bëhen kureshtarë dhe fillojnë ta shohin natyrën ndryshe, jo vetëm si mjedis përreth, por si hapësirë me vlera thelbësore”, theksoi Svetlana Pejoviq, udhëheqëse e programit për edukim ekologjik në organizatë.

Dojrani u zgjodh për shkak të larmisë së habitateve,

botës së pasur bimore dhe shtazore dhe statusit si zonë Ramsar me rëndësi ndërkombëtare, e shpallur në nivel kombëtar edhe monument natyre. “Bëhet fjalë për një laborator të vërtetë në natyrë, ku mund të hasen specie të rëndësishme, përfshirë pelikanët, ndërsa rajoni është i veçantë edhe për lidhjen historike mes njeriut dhe natyrës, siç është peshkimi tradicional me kormoranë”, theksoi Danka Uzunova, koordinatore e projektit dhe ornitologe në organizatë.

Kampi edhe një herë tregoi se të rinjtë e kuptojnë më së miri natyrën përmes hulumtimit të drejtpërdrejtë dhe të mësuarit të përbashkët, gjë që tek ata ndërton një qasje më të përgjegjshme ndaj hapësirës që i rrethon. Projekti financohet nga Agjencia Franceze për Zhvillim.



Qytetarët dhe organizatat shënuan Ditën e Evropës me marsh malor dhe pyllëzim



Me rastin e Ditës së Evropës, qytetarë, institucione dhe organizata në mbarë Maqedoninë morën pjesë në një sërë ngjarjesh kushtuar bashkimit dhe solidaritetit evropian.

Më 2 maj, përballë Europe House në Shkup, u mbajt ngjitja tradicionale malore në Vodno, e organizuar nga Lëvizja Evropiane, me të cilën u paralajmërua Dita e Evropës. Në ngjarje morën pjesë përfaqësues të Lëvizjes Evropiane, të Delegacionit të BE-së, alpinistë me përvojë, por edhe një numër i madh qytetarësh, të udhëhequr nga dëshira

e përbashkët për më shumë bashkim evropian. Gjatë ngjitjes, pjesëmarrësit shkëmbyen flamurin maqedonas dhe atë evropian, një gjest përmes të cilit synuan të dërgonin mesazhin se besimi dhe partneriteti nuk ndërtohen në zyra, por përmes përvojave të përbashkëta dhe përkushtimit të përbashkët.

Nga Lëvizja Evropiane theksojnë se vlerat e alpinizmit në fakt përputhen me ato evropiane: solidariteti, mbështetja reciproke dhe gatishmëria për të qenë gjithmonë mbështetje për personin pranë teje. Pikërisht ky, sipas organizatorëve, ishte edhe mesazhi kryesor i marshit: rruga përpjetë është më e sigurt kur bëhet së bashku.

Shënimi i Ditës së Evropës vazhdoi edhe jashtë Shkupit. Më 12 maj, në Veles, nën sloganin “Evropa jonë – rritemi së bashku!”, u realizua një aksion pyllëzimi mbi liqenin “Mladost” të Velesit, në zonën “Bella Voda”, ku u mbollën 2.500 fidanë frashëri dhe panje. Ngjarja u organizua nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në vend dhe rrjeti Europe House Veles, i cili siguroi fidanët në bashkëpunim me NP “Pyjet e Maqedonisë” – Ekonomia Pyjore “Babuna”.

Në aksionin ekologjik morën pjesë mbi 150 nxënës, të rinj dhe përfaqësues të organizatave, përfshirë ekipin e Shoqatës së Personave me Paralizë Cerebrale dhe Aftësi të tjera të Kufizuara nga Velesi, të cilët së bashku me pjesëmarrësit e tjerë kontribuan për një të ardhme më të gjelbër të qytetit.

Rrjet qytetar për ajër të pastër në Rajonin Jugperëndimor


Shoqata e ekologëve “Natyra” – Strugë, në partneritet me Njësinë e Skautëve “Mirko Mileski” – Kërçovë, filloi vendosjen e instrumenteve për monitorimin e cilësisë së ajrit në komunat Strugë, Ohër, Vevçan, Dibër dhe Kërçovë, si një nga aktivitetet e projektit “Rrjet qytetar për ajër të pastër në Rajonin Jugperëndimor”, mbështetur nga Qeveria e Zvicrës përmes Civika mobilitas.

Instrumentet moderne po vendosen pranë shkollave, kopshteve, spitaleve dhe institucioneve publike, si dhe

në pjesët qendrore të qyteteve dhe do të mundësojnë monitorim të vazhdueshëm dhe qasje të hapur në të dhënat në kohë reale. Qëllimi është rritja e transparencës dhe informimit publik për ndotjen e ajrit, por edhe ngritja e vetëdijes së qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik. Përmes platformës online www.klimerko.org, banorët e rajonit do të mund të ndjekin në çdo moment parametrat e cilësisë së ajrit në komunën e tyre.

Në Strugë, në kuadër të projektit, organizatorët mbajtën edhe trajnimin e parë për ajër të pastër. Ngjarjen e hapi koordinatori i projektit Bardhyl Tushi, i cili prezantoi qëllimet e projektit, pas së cilës profesori universitar Musah Fejzulov, i angazhuar si ekspert për përgatitjen e doracakut edukativ, prezantoi dhe realizoi detyra interaktive me nxënësit. Në trajnim mori pjesë edhe Besa Tateshi, udhëheqëse sektori në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, e cila mbështeti rëndësinë e përfshirjes së të rinjve në mbrojtjen e mjedisit.

Projekti përfaqëson një hap drejt krijimit të një rrjeti qytetar për monitorimin e ajrit, duke përfshirë komunitetin, institucionet dhe qytetarët në mbrojtjen e mjedisit dhe krijimin e politikave më të mira për ajër më të pastër.



Kryqi i Kuq Ohër me një sërë aktivitete me rastin e Ditës Botërore të Kryqit të Kuq

Nën moton “Humaniteti bashkon”, Kryqi i Kuq Ohër shënoi 8 majin, Ditën Botërore të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, të vendosur për nder të ditëlindjes së themeluesit të lëvizjes, Henri Dunant. Shënimi vazhdoi gjatë gjithë Javës së Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, në periudhën nga 8 deri më 15 maj.

Në vetë ditën e festës, një delegacion i Kryqit të Kuq Ohër dhe Shoqatës “Henri Dunant” nga Struga, së bashku me përfaqësues të Komunës së Ohrit dhe vullnetarë nga Klubi i të Rinjve dhe programi për kujdesin ndaj të moshuarve, vendosën lule të freskëta para bustit të Henri Dunant në selinë e organizatës. Po atë ditë u organizua edhe një ditë informuese për fëmijët e institucioneve parashkollore dhe nxënësit e shkollave fillore në Ohër dhe Debërcë, të cilët përmes materialeve promovuese u njohën me misionin e lëvizjes dhe mundësitë për vullnetarizëm.

Gjatë javës, Kryqi i Kuq Ohër organizoi më shumë sesione informuese për grupe të ndryshme të synuara, të orientuara drejt ngritjes së vetëdijes për humanitetin, solidaritetin dhe vullnetarizmin. Mes tyre ishte edhe vizita e fëmijëve nga IPKKF “Jasna Risteska”, të cilët më 11 maj dëgjuan historinë e formimit të lëvizjes dhe u takuan me vullnetarët e grupit për kujdesin ndaj të moshuarve “Gjej kohë”.

Organizata realizoi edhe aktivitete humanitare në vende publike, me theks të veçantë në kontributin e vullnetarëve të rinj në komunitet, ndërsa më 5 maj, në bashkëpunim me Fakultetin e Turizmit dhe Hotelierisë, u realizua edhe një aksion i suksesshëm për dhurimin e gjakut. Në kuadër të shënimit, Kryqi i Kuq Ohër, me mbështetjen e organizatës kanadeze Canadians For Children at Health Risk (CCHR) nga Toronto, përgatiti dhe shpërndau pako humanitare me produkte ushqimore dhe mjete higjienike për familjet që jetojnë në rrezik social në Ohër dhe Debërcë.



Trajnim për gazetarë dhe aktiviste për raportim të ndjeshëm gjinor

Në kuadër të projektit “Gazetari e ndjeshme gjinore për pluralizëm mediatik lokal (REM)”, OJQ Info qendra filloi një seri prej pesë sesionesh edukative online kushtuar barazisë gjinore dhe gazetarisë etike e të ndjeshme gjinore. Në sesione marrin pjesë pesë ekipe, secili i përbërë nga një gazetarë dhe një aktiviste qytetare, të cilat përmes

studimeve të rastit, diskutimeve grupore dhe ushtrimeve praktike i avancojnë njohuritë e tyre për stereotipet gjinore, dhunën me bazë gjinore, dezinformatat gjinore dhe përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore në sferën publike.

Dy sesionet e para, të mbajtura më 21 maj, u drejtuan nga avokatja dhe ekspertja për barazi gjinore Neda Çallovska, me fokus në dhunën me bazë gjinore dhe dhunën digjitale me bazë gjinore, si dhe në mekanizmat ekzistues të mbrojtjes. Dy sesionet pasuese, të mbajtura më 27 maj, iu kushtuan raportimit të ndjeshëm gjinor dhe raportimit për dhunën me bazë gjinore, dhe u drejtuan nga gazetari dhe eksperti për barazi gjinore Ognjen Janeski.

Projekti zhvillohet në një periudhë kur, sipas organizatorëve, gjithnjë e më shpesh përhapen narrativa antigjinore që e paraqesin barazinë gjinore si kërcënim për vlerat tradicionale, veçanërisht në nivel lokal, ku qasja e kufizuar në informacione të verifikuara dhe kapacitetet më të dobëta mediatike krijojnë terren të favorshëm për interpretime të polarizuara të çështjeve gjinore. Situata përkeqësohet më tej nga fakti se në një numër të madh mediash lokale dhe rajonale në Maqedoninë e Veriut, politikat redaktuese lidhur me barazinë gjinore dhe sigurinë shpesh mbeten vetëm deklarative.

Qëllimi i projektit është forcimi i kapacitetit profesional të mediave lokale dhe rajonale për qasje më të mirë në informacione dhe promovimin e pluralizmit mediatik përmes gazetarisë së përgjegjshme dhe të ndjeshme gjinore.

Projektin “Gazetari e ndjeshme gjinore për pluralizëm

mediatik lokal (REM)” e zbaton OJQ Info qendra, me mbështetjen e projektit MEDIA-Lit, të zbatuar nga Qendra për Edukim Qytetar nga Mali i Zi (CCE/CGO), në partneritet me Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Maqedoninë e Veriut, Qendrën e Tiranës për Ekselencë në Gazetari në Shqipëri dhe Iniciativën Atlantike në Bosnjë dhe Hercegovinë. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Ministria për Zhvillim Rajonal dhe Investime dhe Bashkëpunim me Organizatat Joqeveritare e Qeverisë së Malit të Zi.



Aktivizmi i grave sjell ndryshime në zonat rurale

Shoqata Humanitare “Nëna” nga Kumanova më 25 prill mbajti takimin e tretë rajonal për rrjetëzim në kuadër të projektit “Gra aktive”.

Në takim morën pjesë gra aktiviste nga zonat rurale të Kumanovës, Kriva Pallankës dhe Kratovës, përfaqësues të institucioneve lokale, organizatave qytetare dhe organizatave partnere. Qëllimi ishte të prezantohen rezultatet e arritura, të ndahen përvojat nga terreni dhe të hapet dialog për sfidat dhe mundësitë për pjesëmarrje të mëtejshme të grave në vendimmarrjen lokale.

Në panel-diskutimin “Aktivizmi i grave në veprim”, pjesëmarrëset ndanë shembuj konkretë për ndikimin e projektit në zhvillimin e tyre personal dhe në zhvillimin e komuniteteve të tyre. Njëra nga folëset, përmes njohurive dhe shkathtësive të fituara, kishte arritur të aplikojë dhe të sigurojë grant për avancimin e biznesit të saj, një hap drejt fuqizimit dhe pavarësisë ekonomike. Pjesëmarrëse të tjera folën për ndryshimet në komunitetet e tyre, duke theksuar se procesi nuk kishte qenë i lehtë, por kishte sjellë rezultate konkrete dhe të dukshme, mes tyre edhe sigurimin e vendosjes së kontejnerëve në një nga komunitetet, si rezultat i aktiviteteve të avokimit të orientuara drejt përmirësimit të higjienës publike dhe kushteve të jetesës.

“Në fillim nuk kishim mbështetje nga komuniteti, kishte paragjykim ndaj grave dhe mosbesim se diçka do të realizohej, por vërtet ka përparim”, ndau njëra nga aktivistet, duke vënë në dukje ndryshimin gradual të qëndrimeve dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në proceset

lokale.

Pjesëmarrëset theksuan gjithashtu se aktivizmi i organizuar i grave kontribuon në përfaqësim më të madh të grave në vendimmarrjen lokale, ndërsa në një komunitet arritën të iniciojnë zgjedhjen e një bashkësie vendore në strukturat e së cilës u përfshinë dy gra.

Takimi konfirmoi rëndësinë e rrjetëzimit të grave, solidaritetit dhe avokimit të përbashkët si mekanizma për përmirësimin e pozitës së grave nga zonat rurale.

Nga viti 2024 deri në vitin 2026, projekti “Gra aktive” përfshiu mbi 200 gra nga tetë komunitete në tri komunat, të cilat avancuan njohuritë e tyre për avokimin, pjesëmarrjen lokale dhe fuqizimin ekonomik. Rezultat i angazhimit të tyre janë 58 iniciativa, të bashkuara në 16 kërkesa formale të dorëzuara te pushtetet lokale, ndërsa disa nga pjesëmarrëset morën edhe mbështetje të drejtpërdrejtë për përfshirje në tregun e punës dhe për nisjen e biznesit të tyre.

Projektin e zbaton Shoqata Humanitare “Nëna” Kumanovë në partneritet me Qendrën Rajonale për Bashkëpunim SPEKTAR, Qendrën Rajonale për Zhvillim të Qëndrueshëm – Kratovë dhe Fondacionin për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme – Kumanovë, me mbështetjen e Qeverisë së Zvicrës përmes Civika mobilitas.

Tribunë publike për rëndësinë e pjesëmarrjes së grave në krijimin e politikave lokale



Në Demir Kapi u mbajt një tribunë publike kushtuar rëndësisë së pjesëmarrjes së grave në proceset e vendimmarrjes dhe krijimit të politikave lokale. Në ngjarje morën pjesë përfaqësues të vetëqeverisjeve lokale nga Demir Kapi, Rosomani dhe Gradsko, anëtarë të komisioneve për mundësi të barabarta të grave dhe burrave nga tri komunat, si dhe përfaqësuese të këshillave lokale të grave nga 11 komunitete lokale, të cilat gjatë periudhës së kaluar punuan aktivisht në identifikimin e nevojave dhe prioritetëve të komuniteteve të tyre.

Përmes dialogut të hapur u prezantuan iniciativat e deritanishme për avokimin publik të grave nga zonat rurale dhe mundësitë për avancimin e praktikave konsultative në vetëqeverisjet lokale, me theks të veçantë në nevojën për komunikim të rregullt, transparent dhe dykahësh mes autoriteteve lokale dhe grave nga komunitetet.

Mes përvojave të ndara ishin iniciativat e suksesshme për vendosjen e transportit lokal të subvencionuar, sigurimin e pajisjeve për fëmijë përmes mbledhjes së nënshkrimeve nga popullata, si dhe zgjidhja e çështjes së një kopshti për fëmijë në një nga fshatrat. Pjesëmarrëset folën edhe për barrierat me të cilat ende përballen, përfshirë stereotipet që i pengojnë disa gra të shprehin mendimin e tyre ose të marrin pjesë në takimet e bashkësive lokale.

Nga takimi dolën disa përfundime, si për shembull: nevoja për të përmirësuar komunikimin në terren mes institucioneve dhe popullsisë, vendosja e mekanizmave për pjesëmarrje qytetare që do të jenë njësoj të qasshëm për të gjithë, si dhe përfshirja më e madhe e grave në bashkësitë vendore ku vendoset për zgjidhjen e problemeve lokale.

Pjesëmarrësit u pajtuan se gratë përfaqësojnë një shtytës të rëndësishëm të ndryshimeve pozitive në komunitetet lokale dhe se pjesëmarrja e tyre aktive në planifikim dhe vendimmarrje kontribuon në politika lokale më cilësore dhe më gjithëpërfshirëse.

Aktiviteti është pjesë e projektit “Gratë marrin drejtimin në komunitetet lokale”, të cilin Organizata e Grave “Lobi i grave” – Demir Kapi e zbaton në partneritet me Fondacionin Kvinna till Kvinna, Akcija Zdruzhenka nga Shkupi dhe Shoqatën Humanitare “Nëna” nga Kumanova. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian dhe Ambasada e Suedisë.

Angazhimi qytetar, kultura dhe arti

Rjeti Stella në qershor mbajti rrethin e dytë të mentorimit me vajzat nga programi i mentorimit për të rejtat rome, këtë herë kushtuar angazhimit qytetar dhe artit, përkatësisht pyetjes se si përmes trashëgimisë kulturore dhe shprehjes artistike mund të ndërtohet vetëdija për rëndësinë e krijimtarisë në gjuhën amtare, duke u nisur nga përvoja dhe prejardhja personale.

Në sesion, së bashku me artisten, shkrimtaren dhe aktivisten Xhemiliana Abdullova, kryetare e Qendrës Kulturore dhe Mediatike Rome “Barikanipe”, vajzat u shprehën në mënyrë krijuese përmes shkrimit të një letre drejtuar vetes, ku përshkruan të ardhmen ashtu siç e imagjinojnë pas disa vitesh. Më tej u hapën çështje për angazhimin në komunitete përmes artit, ruajtjen e trashëgimisë kulturore rome, por edhe për mënyrën se si përmes hapave të vegjël mund të arrihen qëllimet e dëshiruara.

Abdullova ndau përvojën e saj me artin, duke treguar se si ai e ndihmoi të marrë guxim dhe ta tregojë historinë e saj përmes poezisë, performancave artistike dhe vizatimit, pas së cilës vajzat biseduan hapur për idetë e tyre, hapat e

ardhshëm dhe mbështetjen që kanë në komunitet.

Aktivitetet janë pjesë e projektit “Të rrënjosura në solidaritet: Gra rome që udhëheqin me zë, vizion dhe fuqi”, i financuar nga Asociacioni Evropian për Demokraci Lokale (ALDA) dhe Agence Française de Développement (AFD).



Nga padukshmëria drejt barazisë – përfshirje e qëndrueshme dhe identitet juridik për komunitetin rom



Me rastin e 8 Prillit, Ditës Ndërkombëtare të Romëve, në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut u mbajt ngjarja “Nga padukshmëria drejt barazisë – përfshirje e qëndrueshme dhe identitet juridik për komunitetin rom”. Ngjarja bashkoi përfaqësues të institucioneve, komunitetit ndërkombëtar, deputetë dhe përfaqësues të komunitetit rom rreth angazhimit të përbashkët për përfshirje më të madhe dhe qasje të barabartë në të drejta, ndërsa u organizua në bashkëpunim me Grupin Parlamentar Ndërpatriak për Mbështetjen e të Drejtave të Romëve, me mbështetjen e Institutit Demokratik Kombëtar, Romalitiko dhe Misionit të OSBE-së në Shkup.

Në panel-diskutimin për përfshirje të qëndrueshme dhe identitet juridik mori pjesë edhe drejtori ekzekutiv i Romalitiko, Elvis Shaqiri. Ai ngrii disa çështje sistemore me të cilat përballlet komuniteti rom. Shaqiri theksoi se do të ishte me rëndësi që Grupi Parlamentar Ndërpatriak këtë vit ta orientojë punën e tij drejt tejkalimit të segregimit në arsimin fillor, për të cilin Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg tashmë ka marrë vendim, drejt zgjidhjes së përsheptuar të lëndëve për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje, si dhe drejt mundësit të qasjes në arsimin fillor për romët që e kanë kaluar moshën shkollore, gjë që më tej do të kontribuonte edhe në përfshirjen e tyre më aktive në tregun e punës.

Nga Romalitiko shprehën gatishmëri të marrin rolin e sekretariatit dhe t'i ofrojnë mbështetje profesionale dhe teknike Grupit Parlamentar Ndërpatriak në procesin e përgatitjes dhe avancimit të ndryshimeve ligjore.

Nga organizata theksojnë se mbeten të përkushtuar ndaj avancimit të identitetit juridik, qasjes së barabartë në të drejta dhe krijimit të zgjidhjeve konkrete për tejkalimin e pabarazive strukturore me të cilat përballen romët, duke besuar se pikërisht përmes fokusit të qartë institucional, bashkëpunimit dhe vullnetit politik këto çështje mund të shënojnë përparim real.

Të rinjtë në Strumicë mësuhan si t'i menaxhojnë më mirë financat personale



Dwaeset mлади лица од Струмица помина низ четири-дневна обука за финансиска писменост, одржана од 11 до 14 мај во Уп хаб (Up Hub) Струмица. Учесниците се запознаа со основите на личното буџетирање, штедењето и инвестирањето, но и со тоа како овие секојдневни одлуки се вклопуваат во поширокиот економски систем, преку даноците и јавните финансии.

Младите денес сè почесто самостојно управуваат со своите пари, изложени на бројни дигитални понуди и финансиски ризици за кои често немаат доволно знаење, а токму на тоа обучувачите Олга Рајчиќ и Пла-

мен Тодоров го засноваа делот од обуката околу инвестирањето, фокусирајќи се на проценката на ризик и принос и претставувајќи го инвестирањето како процес на анализа, а не како случаен избор.

„Финансиските вештини не значат само да знаете да ја пресметате разликата помеѓу приход и трошок. Тие значат да умеете да поставите приоритети, да препознаете ризик, да донесете одлука врз основа на информации и да размислувате за последиците од таа одлука“, вели Рајчиќ, нагласувајќи дека кај младите е особено важно ова да се гради навреме, затоа што малите финансиски навики подоцна стануваат основа за поголема сигурност и самостојност.

Освен теоретскиот дел, учесниците имаа можност и сами да презентираат свои заклучоци на крајот од обуката, применувајќи го наученото на конкретни примери.

Активноста е дел од проектот „Младинска мрежа за финансиска писменост на Југоистокот“, поддржан од Владата на Швајцарија преку Цивика мобилитас, а го спроведуваат здруженијата Промо идеја и Новус од Струмица, заедно со здружението „Круна плус“ од Радовиш.

Shkupi nikoqir i ngjarjeve kulturore evropiane dhe rajonale



Në mesin e majit, Shkupi për disa ditë u shndërrua në qendër të skenës së pavarur kulturore, duke mbledhur artistë, punonjës kulturorë dhe përfaqësues të rrjeteve kulturore evropiane nga vendi, rajoni dhe më gjerë. Shkak ishin dy ngjarje të ndërlidhura, Forumi “Kulturë për zhvillim” (13 dhe 14 maj) dhe konferenca rajonale BEYOND (15 dhe 16 maj), të organizuara nga Hartefakt në bashkëpunim me Klubtura, Kooperativa, Fondacionin për Kulturë A25 dhe Euradia, në hapësira të njohura për skenën e pavarur lokale, si Kinemaja në Ndërtesën e hekurudhës dhe Qendra rinore “Matiçno”.

Forumit “Kulturë për zhvillim”, të parin nga dy ngjarjet, e hapi zëvendësshefja e Misionit të Ambasadës së Zvicrës,

Michal Harari, e cila theksoi rëndësinë e mbështetjes për kulturën e pavarur në kushte të financimit afatgjatë gjithnjë e më të kufizuar, duke rikujtuar se kultura është pjesë thelbësore e shoqërive demokratike. Në të njëjtën ngjarje, një mesazh të ngjashëm dha edhe Sarah Maliqi nga Hartefakt, duke theksuar rolin e artit të angazhuar shoqëror në ndërtimin e komuniteteve më rezistente.

Gjatë dy ditëve të diskutimeve, pjesëmarrësit biseduan për financimin e paqëndrueshëm të sektorit, ngushtimin e hapësirës publike për kulturë dhe kushtet e vështirësuar të punës së artistëve, por edhe për nevojën për lidhje më të fortë rajonale dhe evropiane. Përfaqësues të rrjeteve evropiane, mes tyre Culture Action Europe dhe IETM, u pajtuan se pikërisht përvoja e Ballkanit, e qëndrueshme përmes solidaritetit dhe vetëorganizimit, ka çfarë t'i ofrojë skenës më të gjerë kulturore evropiane.

Sesionet e punës rezultuan me rekomandime konkrete për mbrojtjen e lirisë artistike, ruajtjen e hapësirave kulturore fizike dhe digjitale dhe përfshirjen më të madhe të të rinjve në sektor. Me këtë, Shkupi edhe një herë u konfirmua si vend ku kultura e pavarur nga Ballkani takohet drejtpërdrejt me rrjedhat evropiane.

Aktivitetet janë pjesë e projektit “Kulturë për zhvillim”, i mbështetur nga Qeveria e Zvicrës dhe i zbatuar nga Hartefakt Fund.

Mbështetje, mentorim dhe mundësi të reja për zhvillimin e organizatave qytetare në Radovish



Qendra Burimore Qytetare vazhdon me organizimin e ditëve të hapura në mbarë vendin, me qëllim sigurimin e mbështetjes së drejtpërdrejtë në nivel lokal. Më 12 qershor u mbajt një takim me organizatat lokale në Radovish, i dedikuar shkëmbimit të përvojave dhe diskutimit për sfidat dhe mundësitë për zhvillimin e shoqërisë civile në rajon.

Stole Georgiev, ekspert rajonal për Rajonin Planifikues Juglindor, i informoi të pranishmit për mbështetjen këshilluese dhe mentoruese të qasshme për organizatat e rajonit, ndërsa Valentina Veliçkovska, drejtoreshë ekzekutive e Qendrës Burimore Qytetare, prezantoi gjendjen aktuale në shoqërinë civile dhe mundësitë e disponueshme për financim dhe forcim të kapaciteteve. Në diskutimin e hapur pjesëmarrësit biseduan për nevojat reale të organizatave lokale, duke theksuar se mbështetja e ardhshme duhet të përshtatet pikërisht me to.

Pjesëmarrësit e vlerësuan pozitivisht takimin. Përfaqësues të organizatave lokale theksuan se iniciativa të tilla kontribuojnë në afirmimin e sektorit civil si faktor i rëndësishëm korrigjues në shoqëri, ndërsa veçanërisht përshëndetën shërbimet këshilluese dhe mentoruese të Qendrës, të cilat i ndihmojnë të planifikojnë më mirë aktivitetet e tyre dhe të ndërtojnë partneritete të reja.

“Dita e hapur ishte një mundësi e dobishme për komunikim të drejtpërdrejtë dhe për t'u njohur me mbështetjen që ofron QBQ. Veçanërisht e përshëndesim mundësinë për bashkëpunim të drejtpërdrejtë me ekspertin rajonal për shoqërinë civile. Besojmë se prania e tij në terren dhe

mbështetja mentoruese do të jenë përfitim i rëndësishëm për organizatat në proceset e forcimit të kapaciteteve të tyre, zhvillimit të iniciativave të reja dhe krijimit të partneriteteve të qëndrueshme”, deklaroi Evgenija Doneva nga ADMELIORA, duke shprehur pritjen që aktivitete të tilla të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Ngjarja është pjesë e projektit “Mbështetja e BE-së për

Qendrën Burimore Qytetare – faza 2”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Fondacioni Qendra Burimore Qytetare, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Asociacioni për Iniciativa Demokratike – Gostivar dhe Media Plus – Shtip.

Komunat treguan interes për zhvillimin e shërbimeve socio-ekonomike për gra dhe vajza nga kategori të cënueshme



Bashkësia e Njësisë të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL), NALAS dhe GIZ më 19 qershor mbajtën sesionin e parë informues online për komunat dhe ofruesit e shërbimeve sociale të interesuar të aplikojnë në thirrjen e hapur të Programit për forcimin e kapaciteteve të komunave për avancimin e pjesëmarrjes socio-ekonomike të grave dhe vajzave nga kategori të cënueshme. Në sesion u përfshinë mbi 15 komuna dhe disa ofrues shërbimesh, me fokus në dy grupe të cënueshme: gra dhe vajza viktime të dhunës me bazë gjinore ose dhunës në familje, si dhe gra dhe vajza që jetojnë në zona rurale ose të largëta.

Qëllimi i Programit është t'u mundësojë komunave të zhvillojnë shërbime të integruara socio-ekonomike,

si kombinim i shërbimeve sociale, arsimore dhe të punësimit, të bazuara në dëshmi dhe që u përgjigjen nevojave të shumëfishta të këtyre grupeve të synuara. Në kuadër të procesit, tetë komunat e renditura më lart do të marrin pjesë në një kurs online për hartëzim social dhe krijim politikash, katër prej tyre do të marrin mbështetje shtesë për realizimin e hartëzimit social, ndërsa në fund dy komuna do të përzgjidhen për mbështetje të drejtpërdrejtë financiare dhe teknike në vlerë prej 7.000 euro secila, e destinuar për vendosjen dhe zbatimin fillestar të shërbimeve të reja.

Aktivitetet më pas do të zhvillohen në disa faza, nga hartëzimi social në terren dhe trajnimi në vjeshtë të vitit 2026, përmes dizajnit të koncepteve të shërbimeve, deri te vendosja dhe zbatimi i tyre gjatë vitit 2027, me shkëmbim përfundimtar të përvojave kah fundi i tetorit 2027.

Programi për forcimin e kapaciteteve është pjesë e projektit “Ura për përfshirje”, të cilin e zbatojnë NALAS dhe anëtarët e tij nga Ballkani Perëndimor, në kuadër të projektit rajonal “Avancimi i përfshirjes socio-ekonomike në komunat e Ballkanit Perëndimor” (SPARK), i zbatuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

Siguria dhe shëndeti në punë duhet të përfshijnë edhe rreziqet psikosociale

Me rastin e Ditës Botërore për Siguri dhe Shëndet në Punë, më 28 prill në Shkup u mbajt një ngjarje kushtuar aspekteve psikosociale të punës, stresit, shëndetit mendor të punëtorëve dhe nevojës për mjedise të shëndetshme psikosociale të punës. Ngjarjen e organizoi Këshilli për Siguri dhe Shëndet në Punë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, përmes projektit “Drejt një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm pune në Maqedoninë e Veriut”, të cilin e zbaton Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian.

Në fokus të ngjarjes ishte mesazhi se siguria dhe shëndeti në punë nuk kufizohen vetëm në mbrojtjen fizike, por nënkuptojnë edhe kujdes sistemor për mirëqenien

mendore, organizimin e punës dhe parandalimin e stresit. Përfaqësuesit e institucioneve, Bashkimit Evropian, ONP-së, punëdhënësve dhe sindikatave që morën pjesë në ngjarje u pajtuan se përballja me rreziqet bashkëkohore në vendin e punës kërkon qasje të koordinuar, dialog të fuqishëm social dhe përkushtim të qartë ndaj parandalimit.

Nga Inspektorati Shtetëror i Punës u bë e ditur se numri i lëndimeve me pasoja fatale në punë është zvogëluar krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa inspektimet e realizuara për siguri dhe shëndet në punë gjatë vitit 2025 e kanë tejkaluar numrin e planifikuar. Nga institucionet u theksua se vetëm me një qasje sistemore nga të gjithë aktorët pasojat e padëshiruara mund të reduktohen në

minimum.

Pjesëmarrësit iu referuan edhe nevojës për mbrojtjen e dinjitetit të punëtorëve përmes marrëveshjeve kolektive, në vend të kushteve të punës që tejkalojnë standardet ndërkombëtare, si dhe rëndësisë që familjet e punëtorëve të pësuar të mos harrohen në diskutimet për sigurinë në punë.

Në pjesën profesionale të programit, ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë folën për parandalimin e rreziqeve psikosociale përmes organizimit të punës, rolin e rrjeteve evropiane hulumtuese në zhvillimin e strategjive të ndërhyrjes, si dhe për përvojat ndërkombëtare në menaxhimin e këtyre rreziqeve, mes tyre edhe shembulli i Norvegjisë.

Ekipi i projektit të ONP-së theksoi se, edhe pse sistemi për siguri dhe shëndet në punë funksionon, me dhjetëra

mijëra inspektime të realizuara dhe mijëra parregullsi të konstatuara, fokusi ende është kryesisht te rreziqet e dukshme dhe fizike, ndërsa rreziqet psikosociale mbeten të pamjaftueshëm të njohura dhe të evidentuara.

Ngjarja përfundoi me një punëtori mbi temën e dizajnit të mjediseve të shëndetshme psikosociale të punës, me mesazhin e qartë se e ardhmja e sigurisë dhe shëndetit në punë varet nga aftësia e sistemit për t'i njohur dhe adresuar të gjitha rreziqet, të dukshme dhe të padukshme. Projekti “Drejt një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm pune në Maqedoninë e Veriut” vazhdon të punojë për forcimin e kornizës kombëtare për siguri dhe shëndet në punë përmes reformave, forcimit institucional, digjitalizimit dhe mbështetjes së partnerëve socialë.

PJESËMARRJA QYTETARE

Gjykata konstatoi diskriminim ndaj fermereve individuale në qasjen në sigurimin shëndetësor



Gjykata Themelore Civile miratoi një vendim me të cilin konstatoi se fermeret individuale janë viktime të diskriminimit indirekt, të vazhdueshëm dhe ndërsektorial në realizimin e të drejtave nga siguri shëndetësor, konkretisht të drejtës për kompensim page gjatë shtatzënisë, lindjes dhe lehonisë, si dhe gjatë paaftësisë së përkohshme për punë për shkak të sëmundjes ose lëndimit. Me këtë vendim, Qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë janë obliguar të iniciojnë ndryshime dhe plotësime të Ligjit për sigurimin shëndetësor.

Vendimi pasoi pas një padie për mbrojtje nga diskriminimi (actio popularis), të paraqitur nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Parandalimin dhe

Mbrojtjen nga Diskriminimi, si pjesë e projektit “Barazi tani – Fuqizimi i komuniteteve të marginalizuara për përfshirje sociale dhe mosdiskriminim”, i mbështetur nga Qeveria e Zvicrës përmes Civika mobilitas.

Gjykata theksoi se edhe pse fermeret individuale janë të përfshira në sistemin e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor dhe formalisht kanë statusin e personave të siguruar, në praktikë nuk gëzojnë qasje të barabartë në të drejtat që burojnë nga ai sistem. Sipas gjykatës, bëhet fjalë për një rregull ligjor në dukje neutral që i njeh fermeret si të siguruara, por në fakt i përjashton nga kompensimet kryesore në para, edhe pse paguajnë mbi një bazë më të ulët për përlogaritjen e kontributeve dhe megjithatë mbeten kontribuuese reale në sistem.

Në procedurë u mor parasysh edhe mendimi i Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi që nga viti 2023, në të cilin tashmë ishte theksuar se përjashtimi i kësaj kategorie grash nga kompensimet për shtatzëni, lindje, lehonitë dhe paaftësi të përkohshme për punë përbën një formë të diskriminimit indirekt, me thirrje për ndryshime urgjente ligjore.

Problemi, theksohet në procedurë, ka një dimension të theksuar social. Fermeret shpesh detyrohen të vazhdojnë të punojnë edhe gjatë shtatzënisë ose sëmundjes, sepse mungesa nënkupton humbje të drejtpërdrejtë të të ardhurave, gjë që krijon një cikël cenueshmërie dhe marginalizimi të mëtejshëm, në kundërshtim me parimet

e mbrojtjes së amësisë dhe barazisë gjinore.

Gjykata vlerësoi se bëhet fjalë për një problem sistemor që buron nga vetë korniza ligjore, e jo nga raste individuale, dhe se masat ekzistuese të mbështetjes financiare, megjithëse të dobishme, nuk përbëjnë një zgjidhje të

vërtetë sistemore. Pikërisht për këtë arsye, sipas vendimit, e vetmja rrugë drejt qasjes reale në të drejtat e fermereve individuale është ndryshimi thelbësor i ligjit.

Debat i në Kuvend vlerësohet me 5,7; promovohen mjete të reja digjitale dhe iniciativa arsimore për më shumë transparencë dhe pjesëmarrje

Programi zviceran për mbështetjen e Kuvendit vazhdon me aktivitete të orientuara drejt rritjes së hapjes, përgjegjshmërisë dhe gjithëpërfshirjes së organit ligjvënës, përmes analizave të punës së Kuvendit, mjeteve digjitale për transparencë dhe përmbajtjeve edukative për qytetarët dhe të rinjtë.

Mes risive është moduli edukativ “Gazetaria në veprim: Të mësuarit për demokracinë përmes hulumtimit”, i cili tashmë po pilotohet në tri shkolla fillore si pjesë e lëndës së edukimit qytetar, me qëllim që nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike për rolin e tyre si qytetarë aktivë.

Programi investon edhe në zgjidhje digjitale që e afrojnë Kuvendin me qytetarët. Platforma në internet për **zyrat e kontaktit me qytetarët** mundëson caktimin e takimeve me deputetët dhe ndjekjen e iniciativave të paraqitura, ndërsa aplikacioni **“Pyet asistentin AI”**, i zhvilluar përmes një hakatoni parlamentar me studentë, përdor inteligjencën artificiale për analizën e seancave plenare, duke ua lehtësuar qytetarëve, gazetarëve dhe institucioneve kërkimin në materialet e shumta video.

Monitorimi i vazhdueshëm i punës së Kuvendit tregoi se cilësia e debatit është vlerësuar me 5,7 në shkallën nga 1 deri në 10, sipas raportit më të fundit **“Vështrim mbi Kuvendin: Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvend (korrik – dhjetor 2025)”**.

Karvani mobil i Kuvendit, i cili sivjet mbahet për herë të tretë, vendosi fokus të shtuar te të rinjtë dhe universitetet



përmes promovimit të mjeteve të reja digjitale. Karvani filloi më 27 prill në Shtip dhe përfundoi më 5 qershor me një ngjarje në Shkup, ndërsa kaloi nëpër Ohër, Manastir, Sveti Nikollë, Prilep, Gostivar dhe Tetovë.

Programi zviceran për mbështetje parlamentare është projekt i Qeverisë së Zvicrës, nën patronazhin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe zbatohet nga Instituti Demokratik Kombëtar (NDI), në partneritet me Institutin për Demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS) dhe Qendrën për Menaxhimin e Ndryshimeve (QMN).

Korrupsioni i pranishëm në shëndetësi: çdo i pesti punonjës shëndetësor është përballur me të

Shoqata ESE publikoi **hulumtimin “Korrupsioni në shëndetësi - Korrupsioni nga brenda dhe nga jashtë”**, të realizuar në kuadër të projektit “Sistem më i fortë për mbrojtje më të drejtë: Zvogëlimi i korrupsionit në shëndetësi”, me mbështetjen e Agjencisë Franceze për Zhvillim përmes Expertise France, në bashkëpunim me Asociacionin Maqedonas të Gjinekologëve dhe Obstetërve.

“Çdo i pesti punonjës shëndetësor është përballur në një mënyrë me korrupsionin. Hulumtimi ynë mes punonjësve shëndetësorë tregoi se ata janë të vetëdijshëm për ekzistencën e korrupsionit në sektor, ndërsa disa prej tyre kanë qenë të përfshirë ose dëshmitarë të rasteve të tilla”, theksojnë nga ESE.



Hulumtimi, i realizuar mes punonjësve shëndetësorë dhe drejtuesve në institucionet publike shëndetësore, tregon se korrupsioni në shëndetësi është problem sistemor, i pranishëm si në marrëdhëniet me pacientët ashtu edhe në funksionimin e brendshëm të institucioneve.

Pothuajse një e katërta e punonjësve shëndetësorë (22,2 për qind) kanë qenë drejtpërdrejt ose tërthorazi të ekspozuar ndaj korrupsionit në marrëdhëniet me pacientët gjatë 12 muajve të fundit. Më të shpeshtat janë kërkesa e drejtpërdrejtë për para, dhuratat, referimi te shërbimet private të të njëjtit mjek dhe rekomandimi i barnave ose laboratorëve për përfitim personal. Fushë veçanërisht e rrezikshme është veprimtaria gjinekologjike-obstetrike, ku 86,5 për qind e të anketuarve thonë se kërkesa të caktuara korruptive janë dukuri e përsëritur.

Sipas të dhënave nga hulumtimi, çdo i pesti punonjës shëndetësor ka qenë dëshmitar i drejtpërdrejtë ose ka dëgjuar nga kolegët për raste të kërimit të një shërbimi intim në këmbim të një shërbimi shëndetësor. Njëkohësisht, vetëm rreth një e katërta ndihen të informuar ose të edukuar për këtë fenomen.

Ligji për arsimin e lartë nën presionin e kritikave dhe pritshmërive

Qeveria e miratoi tekstin përfundimtar të Ligjit për arsimin e lartë, i cili më pas shkon për shqyrtim në Kuvend, por tashmë ka nxitur debat të gjerë institucional dhe akademik.

Përfaqësuesit e Qeverisë e mbrojnë ligjin si një hap drejt modernizimit të sistemit universitar. Zëvendëskryeministri Bekim Sali theksoi se në të janë përfshirë propozime nga universitetet dhe se askush nuk do të pushohet nga puna, ndërsa ministrja e Arsimit Vesna Janevska sqaroi se H-indeksi (tregues shkencor që kombinon numrin e punimeve të publikuara dhe citimin e tyre nga autorë të tjerë) nuk do të jetë më kriter bazë për zgjedhjen në titull, por element shtesë që do të luajë rol vetëm në rast të numrit të barabartë të pikëve.

Opozita dhe komuniteti akademik mbeten kritikë. Sindikata e Pavarur Akademike theksoi se pjesa më e madhe e propozimeve të tyre nuk janë pranuar, sidomos në pjesën e autonomisë universitare dhe financimit të shkencës. Forumi Arsimor Rinor (FAR) paralajmëron se studentët janë marginalizuar, me vetëm një përfaqësues nga 11 anëtarë në trupin studentor universitar, përkatësisht rreth 9% pjesëmarrje në vendimmarrje, ndërsa Forumi për ndryshime në arsim vlerëson se ligji është instrument për

Korrupsioni është i pranishëm edhe gjatë punësimit, avancimeve dhe shpërndarjes së burimeve. Më shumë se 63 për qind mendojnë se ai herë pas here ose shpesh ndikon në avancimin në karrierë, ndërsa 31,7 për qind besojnë se institucioni i tyre në praktikë zbaton kod etik ose politikë kundër korrupsionit.

“Sipas hulumtimit që realizuam me punonjësit shëndetësorë, iniciativa për korrupsion vjen si nga mjekët, ashtu edhe nga pacientet ose anëtarët e familjeve të tyre”, thonë përfaqësuesit e ESE-së.

Mosraportimi është një nga sfidat më serioze. Vetëm rreth 7 për qind e të anketuarve kanë raportuar zyrtarisht korrupsion, ndërsa si arsye kryesore për heshtjen përmendin mosbesimin se diçka do të ndryshojë, frikën nga pasojat dhe mungesën e provave. Vetëm 17,3 për qind mendojnë se raportuesit janë mjaftueshëm të mbrojtur.

Si masat më të rëndësishme, punonjësit shëndetësorë veçojnë mbrojtjen e raportuesve (77 për qind), e pasuar nga sanksione dhe kontrolle më të rrepta, transparencë më e madhe dhe kushte më të mira pune.

kontroll politik, duke theksuar se shtatë nga 15 anëtarët e Këshillit për Cilësi emërohen drejtpërdrejt nga Qeveria.

Profesori universitar Sahmedin Saliu vlerëson se përbërja e Këshillit të ri Universitar është përmirësuar krahasuar me versionet e mëparshme, duke shtuar se H-indeksi duhet të mbetet vetëm kriter orientues, e jo kusht për titull shkencor. Profesori Azis Pollozhani paralajmëroi se zgjidhjet e nxituara që rrezikojnë të drejtat e studentëve mund ta zvogëlojnë besimin në institucione.

Informacionet e mësipërme janë pjesë e tekstit **“Qeveria miratoi tekstin përfundimtar të Ligjit për arsimin e lartë, debati intensifikohet para procedurës parlamentare”**, i përgatitur në kuadër të projektit “Avokim për zhvillim gjithëpërfshirës”, i mbështetur nga Qeveria e Zvicrës përmes Civika mobilitas dhe i zbatuar nga Forumi për Politika të Arsyeshme, IOHN dhe BIRS.

Takim me qytetarë nga Gjevgjelia dhe Bogdanci për problemet kryesore lokale

Problemi demografik i shpërnguljes së të rinjve dhe plakjes së popullsisë, problemet në shëndetësi, ekologji dhe bujqësi ishin ndër temat kryesore që qytetarët e Gjevgjeliës dhe Bogdancit i ndanë me përfaqësuesit e Institutit RESIS.

Në Gjevgjeli, qytetarët u përqendruan më së shumti në gjendjen e shëndetësisë, duke theksuar mungesën e pediatërve dhe mjekëve specialistë në spital, si dhe ambulancat e lëna pas dore në vendbanimet përreth, të cilat më parë funksiononin me cilësi. Të pranishmit shprehën shqetësim edhe për shpërnguljen masive, por

edhe për faktin se bujqësia praktikisht po zhduket, ndërsa nxitësi kryesor i ekonomisë lokale mbeten kazinotë. Ndër problemet e tjera u përmendën mungesa e transportit publik nga vendbanimet më të vogla deri në qytet, vetëdija e dobët ekologjike e popullsisë dhe paqasshmëria e institucioneve publike për personat me aftësi të kufizuara.

Në Bogdanci, shpërngulja e të rinjve gjithashtu ishte ndër shqetësimet kryesore të banorëve, të cilët theksuan nevojën për mbështetje më të madhe për personat e moshuar që mbeten vetëm në shtëpitë e tyre. Qytetarët theksuan edhe mungesën e mjekëve specialistë dhe laboratorit biokimik në komunë, si dhe pakënaqësinë nga përqendrimi i kapaciteteve energjetike në afërsi, duke përshtatur se janë fjalë për fjalë të rrethuar me turbina ere, ndërsa paralajmërohen edhe centrale të reja fotovoltaike pa përfitim konkret për popullsinë lokale. Ndër problemet e tjera që banorët i ndanë me Institutin RESIS ishin zjarret

në pyjet e zhveshura përreth dhe mungesa e shërbimit zjarrfikës, por edhe pasiguria e rrugës rajonale drejt Gjevgjeliës, për të cilën qytetarët kërkojnë vendosjen urgjente të bankinës.

Njohuritë e mbledhura do të përpunohen më tej dhe do t'i prezantohen redaksisë së medias së komunitetit "Lokal aktiv", e përbërë nga gazetarë lokalë dhe aktivistë qytetarë, me qëllim që problemet kryesore të banorëve të Gjevgjeliës dhe Bogdancit të shndërrohen në tregime hulumtuese dhe analitike që do të rrisin dukshmërinë e tyre dhe do të nxisin zgjidhje institucionale.

Takimet janë pjesë e një cikli më të gjerë konsultimesh në rajonet Lindor, Juglindor dhe të Vardarit, të destinuara për përgatitjen e përmbajtjeve të reja të mediave të komuniteteve.

Komunat e Maqedonisë me hapa të rinj drejt tranzicionit të drejtë energjetik

Në një forum të komunitetit, të organizuar nga Eko-vest në bashkëpunim me Komunën e Kërçovës dhe Bashkësinë lokale Belica, përfaqësues të institucioneve, komunave, TEC Oslomej, sektorit të biznesit, sindikatave, organizatave qytetare dhe institucioneve arsimore diskutuan për rolin e Këshillit Lokal Ekonomik-Social (KLES) Kërçovë në procesin e tranzicionit të drejtë dhe për mundësitë që rajoni të përfshihet më aktivisht në proceset kombëtare të transformimit energjetik.

Ndër rekomandimet kryesore të forumit ishte riaktivizimi i KLES Kërçovë, i cili ekziston që nga viti 2016, por mbetet joaktiv. Pjesëmarrësit u pajtuan se këshilli duhet të zgjerohet me përfaqësues të të gjithë aktorëve relevantë lokalë dhe të shndërrohet në platformë të përhershme për dialog, përgatitje të projekteve të përbashkëta dhe avokim të interesave të rajonit.

"Nevojitet përfshirje më e madhe e komunave në përgatitjen e strategjive dhe planeve kombëtare. Rajonet me qymyr kanë nevojë për mjete financiare shtesë, infrastrukturë më të mirë dhe transport publik për zhvillim ekonomik", deklaroi Darko Beleski, udhëheqës i sektorit për zhvillim ekonomik lokal në Komunën e Kërçovës.

Si mundësi prioritare për zhvillimin e rajonit u përmendën zonat industriale zhvillimore, burimet e ripërtëritshme të energjisë, bujqësia, bletaria dhe turizmi, me theks të veçantë në potencialin turistik dhe kulturor të pashfrytëzuar të rajonit të Kërçovës. Pjesëmarrësit theksuan edhe nevojën për forcimin e infrastrukturës elektroenergjetike dhe përmirësimin e kushteve për sipërmarrjen lokale.

Nga Eko-vest rikujtuam se organizata që në vitin 2020 kishte punuar në skenarë dhe analiza për zhvillim alternativ ekonomik të rajonit, në bashkëpunim me komunitetet lokale. "Hartëzuam shumë atraksione natyrore dhe kulturore që nuk shfrytëzohen aspak. Banorët e Kërçovës i njohin shumë mirë këto potenciale dhe pikërisht për këtë duhet të përfshihen aktivisht në vendimarrjen për transformimin e rajonit", theksoi Elena Nikollovska nga Eko-vest.

Si shembull pozitiv u prezantua përvoja e KLES Manastir, ku përfshirja aktive e institucioneve, sindikatave dhe organizatave qytetare kontribuoi në pjesëmarrje më të fuqishme të rajonit në proceset kombëtare të tranzicionit të drejtë. Në këtë drejtim u paralajmërua edhe iniciativa për formimin e një rrjeti të këshillave lokalë ekonomikë-socialë në nivel kombëtar, me financim të qëndrueshëm për funksionimin e tyre.

Përfundimi i takimit ishte se tranzicioni i suksesshëm dhe i drejtë kërkon institucione të fuqishme lokale, pjesëmarrje aktive të qytetarëve, menaxhim transparent të mjeteve dhe rol më të madh të komunave në krijimin e politikave për zhvillimin e rajoneve të varura nga qymyri.

Si pjesë e përpjekjeve për forcimin e kapaciteteve lokale për tranzicion energjetik, Eko-vest, me mbështetjen e Fondacionit Heinrich Böll dhe Suedisë, organizoi edhe një vizitë studimore në Kroaci për kryetarët dhe sekretarët e komunave Manastir, Kërçovë, Novaci, Demir Kapi, Kumanovë dhe Vevčan. Në periudhën nga 15 deri më 18 qershor ata u njohën me modele të suksesshme të komuniteteve qytetare energjetike në Zagreb, Pushça, Zabok, Krizhevc dhe Rijekë, ku qytetarët dhe vetëqeverisjet lokale investojnë, prodhojnë dhe menaxhojnë së bashku energjinë e ripërtëritshme.

Vizita studimore ishte e orientuar drejt shkëmbimit të përvojave që do të ndihmojnë në zbatimin e Ligjit të ri për energjetikë dhe Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë në nivel lokal. Pjesëmarrësit patën mundësi t'i vizitojnë drejtpërdrejt projektet dhe të binden për përfitimet ekonomike, sociale dhe ekologjike që sjell ky model. Përvojat e mësuara do t'i ndihmojnë komunat e Maqedonisë t'i zbatojnë më lehtë mundësitë e reja ligjore dhe të zhvillojnë iniciativa lokale energjetike në bashkëpunim me qytetarët, institucionet dhe sektorin e biznesit.

SHGM dhe UNDP iniciuan Rrjetin joformal për integritetin e informacionit



Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), mbajti takimin e parë konsultativ për formimin e një Rreti joformal për integritetin e informacionit në Maqedoninë e Veriut.

Iniciativa zbatohet në kuadër të mbështetjes globale të Kombeve të Bashkuara për rrjetet e integritetit të informacionit dhe synon të lidhë institucionet, mediat, organizatat qytetare, komunitetin akademik dhe

teknologjik, si dhe partnerët ndërkombëtarë, në përballjen me sfidat e hapësirës bashkëkohore informative.

Në takim u prezantua koncepti i rrjetit, ndërsa pjesëmarrësit shkëmbyen mendime për strukturën, prioritetet dhe mundësitë për veprim të përbashkët në forcimin e integritetit të informacionit dhe rezistencës së publikut ndaj dezinformatave dhe përmbajtjeve manipuluese.

Pjesëmarrësit u pajtuan se keqpërdorimi gjithnjë e më i shpeshtë i teknologjive digjitale, përhapja e dezinformatave dhe gjuha e urrejtjes kërkojnë qasje të koordinuar dhe partneritet mes të gjithë aktorëve, me qëllim mbrojtjen e të drejtës së qytetarëve për informacione të sakta dhe të besueshme.

SHGM dhe UNDP njoftuan se do të vazhdojnë të punojnë me palët e interesuara në zhvillimin e mëtejshëm të iniciativës, me qëllim krijimin e një rrjeti të qëndrueshëm që do të kontribuojë në përmirësimin e mjedisit mediatik dhe besimit në hapësirën publike informative.

Metamorfozis shënoi Ditën Ndërkombëtare të Verifikimit të Fakteve

Fondacioni Metamorfozis shënoi 2 Prillin, Ditën Ndërkombëtare të Verifikimit të Fakteve (Fact Checking Day), duke theksuar rëndësinë e informacioneve të verifikuara dhe rolin e verifikuesve të fakteve në përballjen me dezinformatat.

Si anëtare me të drejta të plota e Rrjetit Ndërkombëtar për Verifikimin e Fakteve (IFCN) që nga viti 2019 dhe anëtare e certifikuar e Rrjetit Evropian për Standarde në Verifikimin e Fakteve (EFCN), Metamorfozis përmes Vistinomer, Meta dhe Portalb kontribuon aktivisht në forcimin e integritetit të hapësirës publike informative.

Gjatë vitit të kaluar, botimet e Metamorfozis publikuan pothuajse 1.000 verifikime faktesh, analiza të pretendimeve manipuluese dhe kontrole të përbushjes së premtimeve parazgjedhore. Nga organizata theksojnë se përhapja e dezinformatave, veçanërisht përmes inteligjencës artificiale dhe rrjeteve sociale, paraqet sfidë gjithnjë e më të madhe, prandaj verifikimi i fakteve mbetet kyç për një publik të informuar dhe procese demokratike.

Shënimi i sivjetëm u mbajt nën moton “Ne qëndrojmë pas fakteve!” (We Stand for Facts!), me të cilën verifikuesit e fakteve në mbarë botën theksuan përkushtimin e tyre ndaj saktësisë, transparencës dhe luftës kundër dezinformatave.



We stand
for
facts.

Fact-Checking Day.

Rrethi i donatorëve i Konekt siguroi mbështetje për tri iniciativa qytetare



Krijimi i një mjedisi mundësues për organizatat qytetare kërkon zhvillimin e modeleve të reja të mbështetjes dhe përfshirjen më të madhe të qytetarëve dhe sektorit privat. Një shembull i tillë është Rrethi i donatorëve i Konekt, i cili tashmë për të shtatin vit me radhë i lidh donatorët individualë dhe korporativë me organizata qytetare që duan të kontribuojnë në zgjidhjen e sfidave shoqërore.

Rrethi i shtatë i donatorëve i Konekt u mbajt më 4 qershor 2026 në ambientet e Telekomit i Maqedonisë në Shkup, ku më shumë se 90 qytetarë u përfshinë në ngjarje përmes donacioneve dhe aktiviteteve për mbledhjen e fondeve. Me donacione të bashkuara u siguruan gjithsej 601.217 denarë për tri iniciativa të organizatave qytetare.

Mbështetja do të drejtohet për:

- Shoqatën për ndihmë dhe mbështetje të personave me afazi HOPE Shkup, për hapjen e Qendrës së parë të specializuar për persona me afazi. Qendra do të sigurojë ndihmë profesionale dhe mbështetje për personat që pas një goditjeje në tru përballen me çrregullime të të folurit, si dhe për familjet e tyre në procesin e rikuperimit.
- Qendrën për Aktivizëm Rinor KRIK, për përmirësimin e kushteve të jetesës së mbështetur të personave me aftësi të kufizuara në katër shtëpitë grupore dhe për zhvillimin e aktiviteteve në Qendrën Kreative “Krikni”. Mjetet do të kontribuojnë në krijimin

e kushteve më të mira për jetë cilësore, shoqërim, kreativitet dhe terapi okupacionale.

- Koalicionin “Të gjithë për gjykim të drejtë”, për vazhdimin e monitorimit të pavarur të procedurave gjyqësore. Mbështetja do të mundësojë ndjekjen e 100 seancave gjyqësore shtesë dhe do të kontribuojë në transparencë, llogaridhënie dhe qasje më të drejtë në drejtësi për qytetarët.

Gjatë përzgjedhjes së iniciativave, Konekt u jep përparësi organizatave qytetare me burime të kufizuara financiare dhe njerëzore, të cilat kanë qasje më të vogël në burimet tradicionale të financimit, por punojnë në çështje me rëndësi për komunitetin.

Rrethi i Donatorëve është model i licencuar i The Funding Network, ndërsa Konekt është partner i këtij rrjeti në Maqedoninë e Veriut dhe organizata e vetme që e zbaton dhe promovon këtë metodologji në vend.

Këshilli për bashkëpunim me Qeverinë mbështeti reagimin e organizatave qytetare për Ligjin për lojërat e fatit



Në seancën e **Këshillit për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile**, të mbajtur më 16 qershor 2026, anëtarët mbështetën reagimin e përbashkët të katër rrjeteve të organizatave qytetare lidhur me Ligjin e ri për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese. Gjatë përgatitjes së propozim-ligjit nuk ishin konsultuar as organizatat qytetare, as Këshilli, ndërsa teksti nuk ishte publikuar fare për komente në Regjistrin e Vetëm Kombëtar Elektronik të Rregulloreve (ENER).

Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi, Rrjeti Kombëtar kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Platforma për Barazi Gjinore dhe Platforma Maqedonase kundër Varfërisë dërguan një reagim të përbashkët të deputetët, duke vlerësuar se ndryshimet e propozuara nuk paraqesin vetëm ndryshim teknik, por precedent serioz me pasoja të mundshme afatgjata për shoqërinë civile, mbrojtjen e kategorive të cënueshme dhe demokracinë në vend.

Organizatrat rikujtuan se prej dekadash sigurojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për persona me aftësi të kufizuara, viktimat të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, persona të moshuar dhe të pafuqishëm, fëmijë, të rinj, gra, romë dhe qytetarë e komunitete të tjera në pozitë të cënueshme. Kërkuan që ndryshimet e propozuara të mos mbështeten në atë formë, por

të tërhiqen ose të ndryshohen më tej, me qëllim që organizatat qytetare, organizatat kombëtare të personave me aftësi të kufizuara dhe Kryqi i Kuq të mbeten qartë të njohura në ligj si subjekte që mund të marrin dhe zbatojnë mjete të destinuara për kategoritë e cënueshme.

Anëtarët e Këshillit konstatuan se organizatat qytetare duhet të përmenden në nenin 18 paragrafi 1 të propozim-ligjit si shfrytëzues të mjeteve për punë me kategoritë e cënueshme, duke theksuar domosdoshmërinë e një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës për krijimin e politikave publike dhe njohjen e qartë të organizatave qytetare si partner të institucioneve. Këshilli e mbështeti reagimin dhe e ngarkoi Departamentin për Bashkëpunim me Organizatat Joqeveritare të përgatisë reagim me shkrim për Ministrinë e Financave dhe Zyrën e Kryetarit të Qeverisë, si dhe kërkesë për Kuvendin për organizimin e një debati publik.

Pavarësisht këtyre iniciativave, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut më 29 qershor 2026 **e miratoi ligjin e ri**. Sipas njoftimit të Ministrisë së Financave, mjetet nga lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese, në vlerë prej 60 deri në 120 milionë denarë në vit, do të vazhdojnë të përdoren për financimin e organizatave kombëtare të personave me aftësi të kufizuara, shoqatave dhe asociacioneve të tyre, shoqatave të qytetarëve për luftën kundër dhunës në familje dhe Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë.

Me këtë, një pjesë e kërkesave të sektorit civil u morën parasysh, sepse kategori të emërtuara të organizatave mbeten të njohura si shfrytëzues të mjeteve. Megjithatë, në tekstin përfundimtar nuk u rikthye formulimi më i gjerë që i njeh organizatat qytetare në përgjithësi si partner në punën me të gjitha kategoritë e cënueshme, dhe as nuk u zbatua një proces transparent dhe gjithëpërfshirës konsultimesh, siç kërkuan rrjetet dhe Këshilli.

Këshilli për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile miratoi Strategjinë për komunikim për periudhën 2026–2028

Dukshmëri më e madhe, pjesëmarrje më e fuqishme dhe dialog më gjithëpërfshirës ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile janë në fokus të **Strategjisë së re për Komunikim të Këshillit për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile për periudhën 2026–2028**.

Këshilli e miratoi Strategjinë në seancën e mbajtur më 16 qershor 2026. Dokumenti paraprakisht ishte shqyrtuar dhe harmonizuar në një **punëtori të mbajtur më 15 dhe 16 qershor**, me mbështetje eksperte nga projekti “Mbështetje teknike për avancimin e mjedisit mundësues për organizatat qytetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, i financuar nga Bashkimi Evropian.

Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë është avancimi i dialogut institucional dhe gjithëpërfshirës ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile për çështje relevante për zhvillimin e shoqërisë civile në Maqedoninë e Veriut.

Strategjia parasheh tri drejtime veprimi: forcimin e pjesëmarrjes së organizatave qytetare në konsultime dhe monitorimin e politikave publike; përmirësimin e dukshmërisë dhe njohjes publike të rolit dhe punës së Këshillit; dhe forcimin e komunikimit sistematik të anëtarëve të Këshillit me institucionet dhe organizatat që përfaqësojnë.

Sipas analizës së gjendjes, edhe pse Këshilli ka vendosur praktika për transparencë dhe informim, ekziston hapësirë për dukshmëri më të madhe jashtë rrethit të palëve të prekura drejtpërdrejt, pjesëmarrje më të madhe të organizatave qytetare në konsultime dhe prani më të rregullt në media.

Strategjia parasheh që komunikimi të bazohet në transparencë dhe llogaridhënie, komunikim të bazuar në dëshmi, qartësi dhe thjeshtësi, gjithëpërfshirje, shtrirje të gjerë dhe qasshmëri. Vëmendje e veçantë i kushtohet arritjes të organizatave më të vogla dhe më pak të dukshme, si dhe tek ato që nuk janë pjesë e rrjeteve tashmë të vendosura.

Në periudhën e ardhshme parashihen aktivitete për përmirësimin e komunikimit institucional, marrëdhënive me publikun, komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm. Ato përfshijnë informim të rregullt përmes faqes së internetit dhe mediave sociale, prani më të madhe mediatike, sesione informuese dhe takime tematike me organizatat qytetare, si dhe krijimin e materialeve të qarta dhe të qasshme të komunikimit.

Me Strategjinë, komunikimi njihet si pjesë e rëndësishme e forcimit të transparencës, pjesëmarrjes dhe dialogut të strukturuar ndërmjet institucioneve dhe shoqërisë civile. Zbatimi i saj do të konkretizohet përmes planeve vjetore të komunikimit, me aktivitete, afate, përgjegjësi dhe tregues të përcaktuar.

LAJME
**NGA CIVICA
MOBILITS**

Dita Ndërkombëtare e Romëve përmes prizmit të shoqërisë civile



Dita Ndërkombëtare e Romëve është edhe një mundësi për të vlerësuar përparimin e shoqërisë lidhur me sfidat me të cilat përballen bashkëqytetarët tanë, por njëkohësisht edhe mundësi për ta njohur kontributin e të gjithë atyre që punojnë çdo ditë për tejkalimin e tyre.

Në këtë proces, organizatat qytetare kanë rol kyç. Ato janë urë ndërmjet komunitetit dhe institucioneve, duke siguruar informacione, mbështetje, avokim dhe shërbime konkrete aty ku sistemi shpesh nuk është mjaftueshëm i qasshëm. Përmes punës në terren, edukimit, mbështetjes psikosociale dhe juridike, shoqërimit deri te institucionet, fuqizimit ekonomik, avokimit, hulumtimeve dhe fushatave publike, ato kontribuojnë në përmirësimin e qasjes në

të drejta dhe shërbime, zvogëlimin e diskriminimit dhe përfshirjen më të madhe të romëve në jetën shoqërore. Ose, siç thotë Samet Skenderi nga organizata InSok, “organizatat qytetare gjithmonë e mbajnë peshën e sfidave të përditshme të komunitetit rom, por njëkohësisht e mbajnë edhe dritën e shpresës”.

Vitet e fundit kanë treguar se mbështetja e organizatave qytetare rome sjell rezultate konkrete.

“Organizatat qytetare rome, përfshirë edhe shoqatën tonë, kanë arritur rezultate të rëndësishme në terren, mes të cilave rritje të informimit të më shumë se 1.200 grave rome për shëndetin seksual dhe riprodhues, mbështetje në qindra raste për realizimin e të drejtave sociale dhe familjare, punë në raste diskriminimi me shoqërim të siguar deri te institucionet, si dhe mbështetje gjatë qasjes në shërbime shëndetësore dhe reagimit ndaj parregullsive, përfshirë edhe pagesat e paligjshme”, theksojnë bashkëpunëtorët nga Shoqata Iniciativa për të Drejtat e Grave nga Shuto Orizari.

Lexoni lajmin e plotë.

Kodi i ri etik për gazetarët: proces që rikthen besimin në media



Në një kohë kur informacionet përhapen me shpejtësi të jashtëzakonshme, ndërsa kufiri mes lajmit të verifikuar dhe dezinformatës bëhet gjithnjë e më i padukshëm, tema e gazetarisë etike përsëri imponohet si çështje kyçe për shoqërinë. Gazetaria, si zëri i publikut, mbart një përgjegjësi që sot është më e madhe se kurrë, sidomos në kushte kur hapësira mediatike është e mbushur me burime të ndryshme që jo gjithmonë udhëhiqen nga standardet profesionale.

Kodi i parë i gazetarisë etike u miratua në vitin 2001 dhe që atëherë nuk është ndryshuar, gjë që e thekson nevojën për përshtatjen e tij me kushtet e reja të raportimit.

Në këtë kontekst, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), në partneritet me Institutin Maqedonas për Media (IMM), zbaton projektin “Forcimi i standardeve etike për besim më të madh në media”, të mbështetur nga Civika mobilitas. Projekti synon të nxisë standarde më të larta profesionalizmi dhe përgjegjshmërie, përmes një procesi që nuk është vetëm përditësim formal, por rishqyrtim thelbësor dhe përshtatje e etikës gazetareske me kushtet bashkëkohore.

Veçanërisht me rëndësi është se procesi i krijimit të Kodit të ri Etik zhvillohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, me pjesëmarrjen aktive të komunitetit të gazetarëve. Grupi i punës, i përbërë nga përfaqësues të SHGM-së, Institutit Maqedonas për Media dhe Këshillit për Etikë në Media, që nga viti 2024 ka përfshirë më shumë se 200 gazetarë, të cilët përmes propozimeve dhe vërejtjeve kontribuojnë në krijimin e draft-versionit. Konsultimet ende vazhdojnë, ndërsa grupi i punës gjatë gjithë periudhës mban takime, zbaton propozime dhe ndryshime, duke u mbështetur në përvoja nga praktiket etike rajonale dhe evropiane.

Lexoni storien e plotë.

3. Fuqia jonë, planeti ynë: sektori civil në krye të ndryshimeve



Çdo vit, 22 prilli na rikujton se planeti nuk mbrohet vetëm me premtime të mëdha, por me punë të përditshme, vendime, zgjidhje praktike dhe komunitete që e dinë se kanë fuqinë për të bërë ndryshim. Motoja e sivjetme e Ditës së Planetit Tokë, “Fuqia jonë, planeti ynë”, lidhet veçanërisht fuqishëm me punën e organizatave qytetare, të cilat përmes njohurive, aktivizmit dhe punës së drejtpërdrejtë me qytetarët e shndërrojnë vetëdijen ekologjike në veprim konkret.

Civika mobilitas e njohu dhe e mbështeti rolin e organizatave qytetare në luftën për mbrojtjen e planetit përmes mbështetjes konkrete financiare dhe programore.

Në kuadër të programit, për mbrojtjen e mjedisit janë ndarë 46 grante për 34 organizata, me buxhet të

përgjithshëm prej 75.729.198 denarësh. Kjo përfaqëson 7,9 për qind të buxhetit të përgjithshëm. Civika mobilitas qëndron fuqishëm pas këtij vizioni përmes mbështetjes së vazhdueshme të sektorit civil, ndërsa pas këtyre shifrave qëndrojnë organizata që punojnë në shkolla, komuna, lagje dhe komunitete lokale, me të rinj, persona me aftësi të kufizuara, institucione dhe qytetarë që duan një mjedis më të shëndetshëm për jetesë dhe që çdo ditë dëshmojnë se planeti ynë varet pikërisht nga fuqia jonë.

Përfituesit e granteve të Civika mobilitas janë të vetëdijshëm për rolin e tyre si urë mes qytetarëve dhe institucioneve, mes njohurisë dhe zakonit, mes problemit dhe zgjidhjes.

Lexoni lajmin e plotë.

Kontributi i organizatave qytetare në lirinë e mediave

„Formësimi i së ardhmes në paqe” është mesazhi global nën të cilin sivjet shënohet 3 Maji – Dita botërore e lirisë së mediave, kushtuar rolit të gazetarisë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, proceseve demokratike dhe interesit publik.

Dita shënohet që nga viti 1993, pas vendimit të Kombeve të Bashkuara dhe rekomandimit të UNESCO-s, me qëllim që të theksohet rëndësia e lirive mediatike, por edhe të vihet në dukje rreziku dhe presionet me të cilat përballen gazetarët në mbarë botën.

Në kontekstin vendor, këto procese mbështeten në masë të konsiderueshme edhe te sektori civil, i cili përmes iniciativave të ndryshme kontribuon në forcimin e standardeve profesionale, debatit publik dhe edukimit mediatik. Programi Civika mobilitas gjatë viteve të fundit ka mbështetur vazhdimisht iniciativë të tilla, të orientuara drejt zhvillimit të sferës mediatike dhe forcimit të një shoqërie të informuar.

Me rastin e ditës së sotme, biseduam me përfaqësues të Institutit Maqedonas për Media, një nga përfituesit e

granteve të Civika mobilitas, për qëndrimet e tyre lidhur me rolin e organizatave qytetare, arritjet e tyre, sfidat me të cilat përballen, si dhe perspektivat për zhvillimin e ardhshëm të lirisë së mediave.

“Organizatat qytetare kanë rol kyç në mbrojtjen dhe avancimin e lirisë së mediave përmes mbështetjes së vazhdueshme të gazetarëve, forcimit të standardeve profesionale dhe avokimit për politika më të mira”, thonë nga IMM.

Sipas tyre, ato veprojnë si korrektiv i institucioneve, por edhe si partner i komunitetit mediatik, duke siguruar hapësirë për dialog, rishqyrtim kritik dhe përgjigje të përbashkët ndaj kërcënimeve për lirinë e shprehjes. Në kontekstin maqedonas, një rol i tillë është veçanërisht i rëndësishëm për shkak të dobësive strukturore afatgjata në sferën mediatike.



Nga IMM theksojnë se puna e tyre prej vitesh është e orientuar drejt forcimit të gazetarisë cilësore përmes edukimit, analizave dhe debateve publike, si dhe drejt avancimit të edukimit mediatik.

Lexoni lajmin e plotë.

Mbështetje praktike për raportim më të lehtë financiar



Më 30 prill 2026, në ambientet e Qendrës Burimore Qytetare (QBQ) në Shkup, ekipi i Civika mobilitas mbajti një punëtori për raportim financiar. Punëtorja ishte e dedikuar për përfituesit e granteve të partneritetit nga thirrja CM-PG-2.

Gjithsej 19 pjesëmarrës nga të 11 përfituesit e granteve, përfshirë koordinatörë projektsh dhe persona përgjegjës për financat, diskutuan me ekipin e Civika mobilitas se si t'i ndjekin dhe raportojnë më lehtë dhe në mënyrë më efikase shpenzimet e krijuara gjatë zbatimit të aktiviteteve të projekteve.

Ekipi i Civika mobilitas prezantoi sistemin e raportimit financiar përmes platformës digjitale për ndarjen

elektronike, ngarkimin dhe menaxhimin e dokumenteve. Me këtë rast u shpjeguan hapat për ngarkimin e dokumentacionit dhe gjenerimin e raportit përfundimtar. Përfituesve të granteve iu mundësua edhe qasje e drejtpërdrejtë në sistem, me mbështetje praktike në kohë reale.

Përfituesit e granteve u interesuan për funksionimin e sistemit, si dhe për çështje të tjera lidhur me zbatimin e granteve konkrete.

“Punëtorja ishte vërtet e dobishme nga disa aspekte, veçanërisht pjesa me tabelën e përbashkët (shared) Excel për shpenzimet dhe raportin financiar. Kjo qasje mundëson ndjekje shumë precize të buxhetit dhe e zvogëlon ndjeshëm rrezikun e mbivendosjeve. Gjithashtu, do të theksonim qartësinë e tabelave dhe mënyrën e kuptueshme të shpjegimit të tyre, si dhe mbështetjen gjatë hyrjes dhe përdorimit të platformës”, shtoi Simona Levi nga Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë “Megjashi”.

Punëtorja kontribuoi në kuptimin më të mirë të procedurave për raportim financiar dhe në komunikim më efikas ndërmjet përfituesve të granteve dhe ekipit të Civika mobilitas gjatë zbatimit të projekteve.

Lexoni lajmin e plotë.

Vizitat monitoruese konfirmuan qëndrueshmërinë e partneriteteve dhe rezultatet e granteve

Во периодот од 8 до 21 мај, тимот на Цивика мобилитас организатат përfituese të granteve. Vizitat u zhvilluan në ambientet e organizatave bartëse të projekteve, ndërsa në takime më së shpeshti ishin të pranishëm edhe përfaqësues të organizatave partnere.

Duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e projekteve po

hyjnë në fazën përfundimtare, vizitat ishin mundësi për biseda me organizatat për përvojat nga zbatimi i granteve, sfidat me të cilat janë përballur, rezultatet e arritura, por edhe për vlerën e partneriteteve të zhvilluara gjatë bashkëpunimit.

Në vizita ishte i përfshirë i gjithë ekipi i Civika mobilitas,

ndërsa bisedat u zhvilluan në Shkup, Manastir, Gostivar, Kumanovë, Negotinë, Strugë, Strumicë dhe Shtip.

Përveç aspekteve administrative dhe programore, fokusi i bisedave u vendos te ndryshimet që grantet kishin nxitur në organizata dhe komunitete, mësimet e nxjerra, iniciativat e reja që kishin dalë nga bashkëpunimi dhe mundësitë për veprim të mëtejshëm të përbashkët.

Ekipi pati mundësi të dëgjojë nga afër se si organizatat i ndërtojnë partneritetet, si përballen me sfidat lokale dhe në çfarë mënyrash projektet kontribuojnë në pjesëmarrje më të fuqishme qytetare, rrjetëzim dhe zhvillim lokal.

Një nga vëzhgimet më të rëndësishme nga vizitat është se partneritetet e vendosura përmes granteve të Civika mobilitas në masë të madhe janë shndërruar në diçka më shumë se bashkëpunim formal projekti. Pothuajse të gjitha organizatat e vizituara e vlerësuan partneritetin e tyre si



të suksesshëm, funksional dhe, çfarë është veçanërisht e rëndësishme, të qëndrueshëm edhe pas përfundimit të grantit.

Lexoni lajmin e plotë.

“Nuk na duhet edhe një aplikacion, por dikush më në fund të na dëgjojë”



Të rinjtë nga Krusheva, Kumanova dhe Tetova mes procedurave të ngadalta dhe përpjekjes së re për dialog digjital me komunat.

Në shumë komuna në Maqedoninë e Veriut, rruga nga një ide deri te ndryshimi real për të rinjtë shpesh përfundon ende pa filluar. Një përpjekje për të raportuar një problem, disa tentativa për të gjetur institucionin e duhur dhe, në fund, ndjenja se përgjigjja ose vonohet ose nuk vjen fare.

“Nuk na duhet edhe një aplikacion, por dikush më në fund të na dëgjojë”, tha një pjesëmarrës i ri në një punëtori në Kumanovë. Një fjalë që në vete mbart frustrimin, por edhe pritjen se gjërat mund të ndryshojnë.

Pikërisht ky hendek ndërmjet të rinjve dhe komunave është në fokus të projektit “Zëri im në qytetin tim”, i cili zbatohet në Krushevë, Kumanovë dhe Tetovë dhe përpiket të hapë një kanal të ri komunikimi përmes një mjeti digjital të bazuar në inteligjencë artificiale.

Të rinjtë nga tri qytetet thonë se më së shpeshti e dinë ku ekziston problemi, por jo saktësisht ku ta raportojnë dhe as si ta ndjekin zgjidhjen e tij. Në Krushevë, komunikimi me komunën nganjëherë funksionon në mënyrë joformale, por kur bëhet fjalë për iniciativa zyrtare, procesi bëhet

i ngadalshëm dhe i paqartë. Në Kumanovë dhe Tetovë, ndërkaq, dominon ndjenja se informacionet janë vështirë të qasshme dhe se përgjigjja kthyesë arrin rrallë.

Projektin e zbatojnë Aleanca Rinore – Krushevë, Qendra për Dialog Ndërkulturor (QDN) dhe Instituti për Zhvillimin e Komunitetit – Tetovë, ndërsa të rinjtë janë përfshirë jo vetëm si përdorues, por edhe si pjesëmarrës aktivë në dizajnimin e zgjidhjes.

Në punëtoritë për inteligjencë artificiale (IA), të mbajtura në Shkup, Kumanovë dhe Tetovë, të rinjtë folën hapur për barrierat në komunikimin me institucionet. Disa prej tyre pranuan se shpesh nuk dinë as nga të fillojnë kur duan të raportojnë një problem dhe as se si përpunohet më tej zëri i tyre.

“Më pëlqeu që më në fund dikush pyeti se çfarë na duhet vërtet, e jo vetëm të na prezantojë një zgjidhje të gatshme”, thotë Zhivorad Arsiq, një nga pjesëmarrësit. “Në këtë mënyrë mund të ndikojmë vërtet se si do të duket mjeti, nga dizajni e deri te përmbajtja.”

Në fillim, disa nga të rinjtë e shihnin me mosbesim idenë e përdorimit të inteligjencës artificiale në komunikimin me komunat, por me zhvillimin e diskutimeve, qëndrimi i tyre ndryshoi drejt një pranimi më të hapur se teknologjia mund ta lehtësojë dhe përshpejtojë komunikimin.

Te storja.

Kodi për organizatat qytetare si mjet për kritikë dhe lavdërim nga vetë sektori



Më 2 qershor 2026, në ambientet e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS), ekipi i Civika mobilitas organizoi punëtorinë e parë kushtuar avancimit të zbatimit të Kodit për organizatat qytetare. Punëtorja mbledhi përfituesit e granteve të Civika mobilitas nga Shkupi, Kumanova, Tetova dhe Gostivari, të cilët diskutuan për mundësitë për forcimin e mekanizmave të monitorimit të Kodit, pesë vjet pas miratimit të tij.

Për historikun dhe përmbajtjen e Kodit për Organizatat Qytetare foli Aleksandra Savevska nga MCMS. Ajo iu referua qëllimeve të punëtorisë dhe rëndësisë së vetërregullimit në sektorin qytetar. Savevska theksoi se ndërtimi i besimit me qytetarët dhe publikun e gjerë mbetet një nga sfidat

më të mëdha dhe se Kodi është instrument përmes të cilit organizatat mund ta konfirmojnë përkushtimin e tyre ndaj interesit publik.

Biljana Nasteska-Kalanoska nga Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) prezantoi Kodin e gazetarëve si praktikë të mirë për vetërregullim. Ajo ndau përvojën e SHGM-së në zbatimin e deritanishëm të Kodit, prezantoi organet e zbatimit dhe mekanizmat e monitorimit, përshkroi sfidat gjatë zbatimit dhe shpjegoi nevojën për përditësimin e tij. Aktualisht, SHGM po punon në rishikimin e Kodit përmes një projekti në vazhdim të mbështetur nga Civika mobilitas, proces që ofron njohuri të dobishme krahasuese për organizatat qytetare.

Pjesa qendrore e punëtorisë iu kushtua punës në grupe, të udhëhequr nga Fanija Ivanovska nga MCMS. Pjesëmarrësit u ndanë në tri grupe, ku secili grup shqyrtoi disa zotime nga Kodi dhe kishte për detyrë të veçonte maksimum 10 parime dhe standarde të domosdoshme, të përshtatshme për monitorim të strukturuar.

Lexoni lajmin e plotë.

Sektorit civil dhe atij të biznesit u nevojiten partneritete për bashkëpunim të qëndrueshëm



“Nga donacionet afatshkurtra drejt partneriteteve afatgjata!” Ky ishte mesazhi kryesor i punëtorisë “Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat dhe shoqërisë civile”, e cila u mbajt më 10 qershor në Shkup. Më shumë se 20 përfaqësues të organizatave qytetare diskutuan se si bashkëpunimi me kompanitë mund të zhvillohet në një model të qëndrueshëm që krijon ndikim më të gjerë shoqëror, në vend që të mbetet në nivelin e mbështetjes ad hoc të ngjarjeve dhe aktiviteteve.

Pjesëmarrësit punuan dhe diskutuan me Simon Forrester, ekspert ndërkombëtar i Civika mobilitas, i cili ndau praktika

evropiane për bashkëpunim të strukturuar dhe afatgjatë ndërmjet sektorit civil, biznesit dhe institucioneve.

Forrester theksoi se në disa vende evropiane bashkëpunimi nuk kufizohet në donacione, por në partneritete të vendosura me rregulla të qarta dhe qëllime të përbashkëta. Si shembull përmendi Danimarkën, ku ekziston “Compact” – dokument që vendos parime të përbashkëta për bashkëpunim. “Kjo është e dobishme sepse organizatat mund t’i referohen atij kur duan të bashkëpunojnë me kompani”, theksoi ai.

Ai shtoi se përgjegjësia shoqërore e korporatave gjithnjë e më shumë po bëhet kornizë për veprim të përbashkët, ndërsa në vende si Danimarka, Irlanda dhe Italia po zhvillohen partneritete në fusha të lidhura me punësimin, arsimin, përfshirjen sociale dhe zhvillimin lokal.

Vëmendje të veçantë nxiti diskutimi për gjendjen në Maqedoninë e Veriut. Pjesëmarrësit ndanë përvoja që tregojnë se kompanitë më së shpeshti mbështesin ngjarje dhe aktivitete konkrete, ndërsa shumë më rrallë përfshihen në partneritete afatgjata që kontribuojnë në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e vetë organizatave.

Përfaqësues të disa organizatave theksuan se bashkëpunimi me bizneset lokale shpesh ndërtohet gradualisht, përmes kontakteve personale, besimit dhe komunikimit të vazhdueshëm. U ndanë shembuj të kompanive që sigurojnë mbështetje financiare, pajisje, produkte ose shërbime për realizimin e aktiviteteve me interes publik, por edhe përvoja që tregojnë se sa e vështirë është për

organizatat ta shpjegojnë dhe paraqesin ndikimin e tyre para mbështetësve potencialë.

Lexoni më shumë.

“Çdo gazetar është edhe aktivist dhe çdo aktivist është edhe gazetar”



CSara Tanaskoska është gazetare e re nga Struga. Deri vonë ka punuar në një media ku temat lokale rrallë gjenin hapësirë. Jo për shkak të mungesës së interesit, por sepse sistemi thjesht nuk ofronte hapësirë për to. “Dua të kontribuoj më shumë për komunitetin tim lokal. Deri tani nuk kam pasur mundësi që në ndonjë media t’i trajtoj në mënyrë të thelluar temat lokale, prandaj këtë trajnim e shoh si mundësi për të fituar njohuri dhe shkathtësi për këtë”, tha ajo gjatë punëtorisë së Lokal Aktiv në Ohër.

Në një largësi prej 130 kilometrash, në Tetovë, Angell Dimovski, gazetar i ri, thotë diçka të ngjashme. “Arsyeja kryesore pse u përfshiva është se dua të kontribuoj në gazetarinë lokale dhe në zgjidhjen e problemeve në komunitet”, thotë ai. Ndërsa në Vallandovë, aktivistja Ljubica Stojanovska kishte një arsye tjetër, por plotësuese: “U përfshiva për t’i ndjekur zhvillimet aktuale për informim të drejtë dhe avokim para institucioneve publike.” Tre njerëz, tri rajone të ndryshme, një problem i përbashkët dhe përfundimi se komunitetet lokale nuk e kanë zërin e tyre.

Pikërisht kjo është thelbi i projektit “Media të komunitetit për shoqëri civile më të fuqishme”, të cilin e zbatojnë Instituti RESIS dhe Këshilli për Etikë në Mediat e Maqedonisë (KEMM).

Gjatë qershorit, RESIS dhe KEMM organizuan punëtori në tri rajone: Juglindor, Jugperëndimor dhe të Pollogut. Punëtoritë shërbyen për të vendosur themelet e redaksive të ardhshme të mediave të komunitetit atje ku të tilla ende nuk ekzistojnë. Ajo që punëtoritë konfirmuan është diçka që ndoshta shumëkush e ndien, por rrallë e emërton: një pjesë e madhe e Maqedonisë rrezikon të bëhet “shkretëtirë mediatike”. Jo sepse nuk ka media, por sepse ato ekzistuese nuk prodhojnë përmbajtje që burojnë nga komunitetet lokale dhe i shërbejnë interesit të tyre publik. Presioni politik dhe korporativ mbi mediat lokale, paqëndrueshmëria e tyre financiare, të ardhurat e ulëta të gazetarëve dhe mungesa e instrumenteve për komunikim qytetar... Të gjitha këto sfida së bashku çojnë në të njëjtën pasojë: qytetarët nuk e dinë se kanë të drejtë të kërkojnë, nuk dinë ku të kërkojnë dhe shpesh nuk e dinë as se problemi i tyre është problem.

Pjesëmarrësit në punëtori e kanë përjetuar këtë në lëkurën e tyre. Përmes diskutimeve paraqitën realitetet konkrete të secilit rajon. Në rajonin e Pollogut, gazetarët dhe aktivistët folën për urbanizimin e dobët dhe ndotjen në Tetovë. Një rajon që, sipas tyre, shënon rritje të rrezikut nga sëmundjet malinje, por rrallë merr hapësirën e duhur mediatike për këtë. Në rajonin Juglindor, fokusin e vendosën te deponitë e egra dhe shkatërrimi i pyjeve me pisha, por edhe te shpërngulja “e heshtur” e të rinjve, temë për të cilën pothuajse askush nuk shkruan. Në rajonin Jugperëndimor, pjesëmarrësit ngritën çështjet e ujit të pijshëm, deponive dhe reformës në shëndetësi.

Lexoni storien e plotë.



Adresari



Burime



**Revista
„Qytetarët për ndryshim“**



Lajme nga organizatat qytetare



Histori



Impulsi Qytetar



**Kodi i organizave të shoqërisë
civile**



**Financimi shtetëror për
organizatat e shoqërisë civile**



**Civica Mobilitas
Community**



**Civica Mobilitas
ePlatform**

QYTETARËT PËR NDRYSHIME

Kryeredaktor: Gonca Jakovleska

Redaktor: Karolina Gjurovska

Adresa e Botuesit: Rr. Nikolla Parapunov nr. 41a, f.p 55, 10160 Shkup

Tel: ++ 389 (0) 2 3065 381

e-mail: helpdesk@civicamobilitas.mk



„Qytetarët për ndryshim“ e boton programi Civica Mobilitas i mbështetur financiarisht nga Agjencioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), implementuar nga NIRAS nga Danimarka, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) dhe FCG nga Suedia.

Artikujt e botuar në këtë revistë shprehin pikëpamjet e autorëve dhe/ose organizatave që kontribuojnë në revistë, por jo ato të Ambasadës Zvicerane/Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim ose ato të organizatave implementuese: NIRAS, MCMS ose FCG.

www.civicamobilitas.mk